



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOŠOVA


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Prilijeno: 25.07.2024		
Mjesia Jednica	Numeri Shtoj	Shtojca Dodatak
01-052/01-35834		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Datë:	24.07.2024
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi – Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Komisioni për hartimin e Planit në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit. 
Lënda:	Raport nga procesi i konsultimit publik nga Draft Planit i orareve të rëndeve të udhëtimeve për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2024-2028

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për hartimin e Planit të orareve dhe rëndeve të udhëtimeve për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2024-2028 dhe Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Draft Planin e orareve të rrendeve të udhëtimeve për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2024-2028

Ku është publikuar edhe njoftimi me bashkëlidhjen e konsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik ky dokument si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet. Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës si dhe në platformen e konsultimeve publike të Qeverisë së Kosovës.

Shih linqet:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42527>

https://kk.rks-gov.net/lipjan/?page_id=200034772

Ecuria e Procesit

Komisioni për hartimin e Rregullores në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispoziatat e Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna. Në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike ka publikur në web faqen e komunës njoftimin me datë 09.07.2024 për mbajtjen e konsultimit-debatit publik për Planin komunal i veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2024-2026 njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës.

në linkun:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2024/07/Njoftimi-per-debat-publik-Plani-i-Transportit-3.pdf>

Ndërsa takimi konsultativ-debati është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. 18.07.2024 është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke filluar nga ora 10:00

Ky Propozim Plan u prezantua nga zyrtarët e Drejtoratit për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim: Rafete Retkoceri Jetullahu dhe Rrahman Olluri.

Rafete Retkoceri Jetullahu para të pranishmëve ka potencuar se Komuna e Lipjanit ka përfillur të gjitha procedurat për të konsultuar me publikun lidhur me këtë Plan i cili pritet të miratohet në seancën e Kuvendit të Komunës. Më tutje znj. Retkoceri tha se me këtë plan Komuna e Lipjanit synon përmbushjen e nevojave të qytetarëve për transport me autobus planifikon numrin e nisjeve dhe orareve të nisjeve për rendet e udhëtimit për linjat e transportit urbano – periferik të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit.

Po ashu hartuesit e këtij dokumenti kanë kërkuar nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafti pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete rreth këtij Propozim Plani.



Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë çështje, duke përfshirë: qëllimin e hartimit të këtij Plani, afatin e zbatimit të planit dhe të gjitha oraret për të gjitha linjat e përcaktuara me plan.

Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet / komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Draft Planin e orareve të redevë të udhëtimeve për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2024-2028	Ka shprehur interesimin që linja e transportit publik me autobus në relacionin Akllap-Lipjan dhe se a është e përfshirë kjo linjë në planin e transportit.	Vlora Krasniqi	Rrahman Olluri – zyrtar për komunikacion në Drejtoratin për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim e sqaroi se kjo linjë është e përfshirë në Propozim plan me numrin rendor 5 Relacioni Akllap – Lipjan.	Komenti u pranua plotësisht
Draft Planin e orareve të redevë të udhëtimeve për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Lipjanit 2024-2028	Ka kërkuar që të shqyrtohet mundësia që të ketë ndonjë linje brenda qytetit të Lipjanit duke pasur parasysh rritjen e numrit të banorëve në qyteti.	Salie Marevci	- Komisioni ka potencuar se do të shqyrtohet kjo mundësi pasi që konsiderohet e nevojshme të krijohet edhe një linjë e re e transportit për mbulueshmëri në qytetin e Lipjanit.	Komenti u pranua plotësisht

Takimi përfundoi në ora 11:10.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	30 ditë pranohen	12
2. Publikimi në ueb faqe	15 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 12 pjesëmarrës, prej tyre 6 femra dhe 6 meshkuj.

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike

Shtojcë: Lista e pjesëmarrësve

